

Pershendetje,

Lidhur me informacionin e kerkuar, ju informojme se:

Personat e siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor regjistrohen në regjistrin elektronik të të siguarve, i krijuar dhe i menaxhuar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Zgjedhja e mjekut bëhet nëpërmjet plotësimit të formularit tip me titull “Kërkesë për regjistrim/përditësim personi” nga personi që bën kërkesën dhe Mjeku i Përgjithshëm nga i cili dëshiron të marrë shërbimin shëndetësor, kur ky i fundit është dakord. Formulari nënshkruhet nga të dy palët.

Për shtetasit e huaj, regjistrimi në sistem do të bëhet pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit kundrejt dokumentacionit:

- Formular tip me titull “Kërkesë për regjistrim/përditësim personi”.
- Leje e qëndrimit me afat të vlefshëm nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Personat që kanë statusin e të siguarit në regjistrin elektronik të të siguarve, sipas kategorive përkatëse, përfitojnë shërbimet e kontraktuara nga Fondi, sipas parashikimit në aktet ligjore dhe nënligjore. Një person mund të klasifikohet në një ose më shumë kategori përfituese.

Dite te mbare!